



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Nr. 943 Prot.

Tiranë, më 07.02.2025

SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE, Ngritjen në detyrë DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist i Teknologjisë së Informacionit)

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Këshilli i Lartë Gjyqësor shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

I.1 (një) pozicion – Specialist i Teknologjisë së Informacionit (kategoria IV 1)

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE: **20 shkurt 2024**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR: **27 shkurt 2024**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

Specialist i teknologjisë së informacionit:

Detyrat funksionale:

- Zbaton aktet normative nënligjore në fuqi lidhur me teknologjinë e informacionit;
- Mirëmban sistemin ekzistues të kompjuterëve në drejtim hardware dhe software kryen kontroll periodik mujor të gjendjes së pajisjeve elektronike të gjykatës si dhe backup 36 periodik, zakonisht ditor, të të dhënave sensitive, databazës së sistemit të të dhënave ARKIT, së sistemit audio RDA, si dhe arkivit qendror të transfertës së gjyqtarëve;
- Bashkëpunon dhe mban lidhje me sektorët dhe eprorët përkatës për problemet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në konfigurimin e email,

serverit të brendshëm si dhe domain-it të gjykatës, krijimin e përdoruesit e gjykatës (kryetar, kancelar, gjyqtar, sekretarë, etj.), korrigjimin e gabimeve të bëra nga përdoruesit me lejen e eprorit të gjykatës, pajisjen e çdo nëpunës civil gjyqësor të gjykatës me akseset e nevojshme në sistemet elektronike, në përputhje me detyrat e punonjësit; kopjimin e CD-ve audio të dosjeve të dorëzuara nga sekretarët; ndërhyrjen në sistem për ndryshimin e seksionet e gjyqtarëve në bazë të urdhrin të nxjerrë nga Këshilli i Gjykatës;

- d) Monitoron, administron dhe mirëmban infrastrukturën kompjuterike dhe informatike në gjykatë me anë të operacioneve periodike për të garantuar funksionimin e tyre normal, përfshirë këtu (por duke mos u kufizuar me to) testimin e pajisjeve, monitorimin, përditësimin, dhe kryerjen e kopjeve rezervë dhe raporteve, etj.,- gjurmimin e çdo veprimi të kryer nga përdoruesit e sistemit si dhe të ngarkesës së gjyqtarëve që marrin pjesë në short; d) Ofron mbështetje për gjyqtarët si dhe nëpunësit civil gjyqësor pa vonesë në raste kërkesash për problemet kompjuterike për gjykatën;
- e) Mirëmban dhe mbështet infrastrukturën informative të gjykatës: rrjetin e brendshëm kompjuterik (LAN/WAN) dhe siguron komunikimin e të dhënave;
- f) Përditëson faqen zyrtare të gjykatës me informacionet më të fundit në bashkëpunim me sektorët e tjerë, duke përfshirë por pa u kufizuar në: afishimin e listave të gjykimeve në faqen e gjykatës, ndalimin e publikimin e dosjeve me të dhëna tepër sensitive, siç është birësimi, etj., në faqen e gjykatës;
- g) Bashkëpunon me sektorë të tjerë të gjykatës statistika për raportimet për qëllime të ndryshme sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
- h) Ndërton dhe mirëmban një sistemi elektronik të brendshëm të statistikave të kategorive të ndryshme të të dhënave në bashkëpunim me nëpunësit civil gjyqësor përkatës: të dhënat volumetrike, të inventarit dhe të përpunimit për efekt të matjes së performancës së gjykatës dhe nëpunësve civil të saj; etj

II. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit gjyqësor.

II.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori IV-1.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit

Përvoja: Të ketë kryer të paktën 1 vit praktikë profesionale.

Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj – preferencë për gjuhët e BE-se;

Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide,

mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

II.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>.
- b) Kërkesë motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës.
- c) Fotokopje e diplomës dhe të listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d) Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- e) Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f) Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- g) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- h) Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal.
- i) Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
- j) Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- k) Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- m) Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit si drejtues i nivelit të ulët.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo me email në adresën infocivile@gjykata.gov.al brenda datës **20.02.2025**

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **21.02.2025**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

II.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a-
- b- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- c- Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- ç- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
- e- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

II.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), si më poshtë:

- a) **40 (dyzet) pikë** për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
- b) **50 (pesëdhjetë) pikë** për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) **10 (dhjetë) pikë** për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

II.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari i Gjykatës, do të njoftojë për fituesin e shpallur nga Këshilli i Gjykatës në faqen zyrtare www.klgj.gov.al dhe www.gjykatatirana.gov.al

II.PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data **21.02.2025***

Kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e janë të njëjta me ato të “Lëvizjes paralele”.

III.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet, deri më datë **27.02.2025**, si më poshtë vijon:

- a) Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.
- b) Kërkesë motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës.
- c) Fotokopje e diplomës dhe të listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d) Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- e) Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f) Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- g) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- h) Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal.
- i) Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
- j) Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- k) Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- m) Aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit si drejtues i nivelit të ulët.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

III.2 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.02.2025**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

III.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË TESTOHET KANDIDATI

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a) Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- c) Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- d) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- e) Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
- f) Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgi.al dhe të Gjykatës duke filluar nga data **20.02.2025**.